

VENDIM
Nr.512, datë 8.8.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR REALIZIMIN, ME SHOQËRINË "MICROSOFT", TË PROJEKTIT TË PARTNERITETIT STRATEGJIK, NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t'i shtohet fondi prej 142 000 000 (njëqind e dyzet e dy milionë) lekësh, si pjesë e fondit të përgjithshëm 426 000 000 (katërqind e njëzet e gjashtë) milionë lekë, për realizimin, me shoqërinë "Microsoft", të projektit të partneritetit strategjik, në fushën e teknologjisë së informacionit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha